

Aneks-kontratë e Kontratës së përgjithshme për shitje-blerje të menjëhershme të letrave me vlerë me detyrim për riblerjen/shitjen e tyre
(Kontrata e përgjithshme repo)

Lidhur në _____ më datë _____, midis:

1. _____, (në tekstin e mëposhtëm: pala kontraktuese)
2. _____, (në tekstin e mëposhtëm: pala kontraktuese)

Neni 1

Në nenin 2 të Kontratës së përgjithshme për shitje/blerje të menjëhershme të letrave me vlerë me detyrim për riblerje/shitjen e tyre (më tej në tekst: Kontrata e përgjithshme repo), e nënshkruar ndërmjet palëve kontraktuese më vitin 1.2.2012, përkufizimi "Ditë pune" ndryshon dhe bëhet:

"Ditë pune" nënkupton:

- (a) Sa i përket transferimit të mjeteve në denar, dita në të cilën MIPS-i (Sistemi i Pagesave Ndërbankare të Maqedonisë) është i hapur për punë;
- (b) Në lidhje me transferimin e mjeteve në euro, dita në të cilën TARGET 2 (Trans-European Automated Real-time Gross Settlement Express Transfer System) është i hapur për punë;
- (c) Përsa i përket transferimit të pronësisë së letrave me vlerë, dita në të cilën depozitat në të cilat është regjistruar pronësia e letrave janë të hapura për punë.

Neni 2

Në nenin 2, pas përkufizimit "Ditë pune", shtohen dy përkufizime të reja, që thonë:

"Valutë kontraktuese" është valuta në të cilën kryhet transferimi i mjeteve monetare në lidhje me çmimin e blerjes dhe riblerjes së letrave me vlerë.

"Valutë bazë" është denari maqedonas (MKD), në të cilin bëhet llogaritja e ekspozimit neto nga të gjitha transaksionet e lidhura ndërmjet palëve kontraktuese dhe transferimi i mbulimit.

Neni 3

Në nenin 5, paragrafi (2) ndryshohet dhe bëhet:

"Me përjashtim, gjatë transferimit të mjeteve monetare në euro dhe/ose në rast se letrat me vlerë që janë lëndë e transaksionit nuk janë të shprehura në valutën bazë, palët kontraktuese do të bien dakord për radhën e transferimit të mjeteve dhe pronësinë e letrave me vlerë. Në këtë rast, kalimi i pronësisë së letrave me vlerë mund të kryhet pa transferimin e parave, sipas parimit të "dorëzimit pa pagesë".

Neni 4

Neni 7 ndryshohet dhe bëhet:

“Në rast se letrat me vlerë që janë lëndë e transaksionit nuk janë të shprehura në valutën kontraktuale, llogaritja e detyrimeve monetare kryhet duke zbatuar kursin e mesëm të publikuar në listën e kursit të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose kurs tjetër këmbimi që do të bien dakord të dyja palët, i cili është i vlefshëm në ditën e llogaritjes së detyrimeve monetare”.

Neni 5

Pas nenit 11, shtohet nen i ri 11-a, i cili thotë:

“Në rast se letrat me vlerë që janë lëndë e transaksionit janë të shprehura në valutën kontraktuale, gjatë llogaritjes së ekspozimit, palët kontraktuese zbatojnë valutën kontraktuale.

Në rast se letrat me vlerë që janë lëndë e transaksionit nuk janë të shprehura në valutën kontraktuale, gjatë llogaritjes së ekspozimit, do të zbatohet valuta bazë dhe kursi mesatar i këmbimit i publikuar në listën e kursit të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose kurs tjetër këmbimi që do të bien dakord të dyja palët, i cili është i vlefshëm në ditën e llogaritjes së detyrimeve monetare”.

Neni 6

Në nenin 12, pas paragrafit (12), shtohet paragraf i ri (3), i cili thotë:

“Gjatë llogaritjes së ekspozimit neto, palët kontraktuese do të zbatojnë valutën bazë”.

Neni 7

Në shtojcën 1, në pikën 17), fjalët “për vlerësimin në denarë të letrave me vlerë në valutë dhe letrave me vlerë me klauzolë valutore” fshihen.

Neni 8

Kjo aneks-kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj, me afat vlefshmërie me kohë të pacaktuar.

Neni 9

Kjo aneks-kontratë është lidhur në 4 (katër) kopje identike, nga 2 (dy) kopje për secilën palë kontraktuese.

Pala kontraktuese
Emri i bankës

Personi i autorizuar
Emri dhe mbiemri

Pala kontraktuese
Emri i bankës

Personi i autorizuar
Emri dhe mbiemri